

Njoftim për përqendrim me të cilin Lamium Trejd Limited (Lamium Trade Limited), Limasol Qipro dhe ALFI Rinjavabs upravljanje skladov, d.o.o. (ALFI Renewables upravljanie skladov, d.o.o.), Lubjanë, Slloveni (rruga Verovškova 55A, Lubjanë Slloveni), kanë për qëllim të fitojnë kontroll të drejtpërdrejtë ndaj Ivikom Enerxhi, d.o.o. Zhagubica (Ivicom Energy, d.o.o. Žagubica), Serbi

(lënda nr. 08-37/2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 07.02..2022, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin "Lamium Trejd Limited" (Lamium Trade Limited), shoqëri e cila është organizuar në përputhje me ligjet e Qipros, me seli në Griva Digeni 115, Qendrën Trident, 3103 Limasol (Griva Digeni, 115, TRIDENT CENTRE, 3103 limassol) dhe ALFI Rinjavabs upravljanje skladov, d.o.o. (ALFI Renewables upravljanie skladov, d.o.o.), shoqëri e cila është e organizuar në përputhje me ligjet e Sllovenisë, me seli rrugën Verovshkova 55A, Lubjanë, Slloveni (Verovškova ulica 55A, Ljubljana , Slovenia), kanë për qëllim të fitojnë kontroll të drejtpërdrejtë ndaj "Ivikom Enerxhi", d.o.o. Zhagubica (Ivicom Energy, d.o.o. Žagubica), shoqëri e cila është e organizuar në përputhje me ligjet e Serbisë, me seli në Bogdanovë Jugore 2, Serbi (Jug Bogdanova 2, Serbia).

Lamium Trejd Limited është një kompani Holding që zotëron disa shoqëri në rajon të cilët janë aktive në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

ALFI Rinjavabs është aktive në menaxhimin e fondeve të investimeve alternative.

ALFI Rinjavabs nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut. Megjithatë, grupi i tij i korporatave ka një shoqëri të varur në pronësi shumicë – Shoqëria e shërbimeve "PRO KOLEKT" SHPKNJP Shkup (**PRO KOLEKT DOOEL Skopje**), me adresë të regjistruar në Hristo Tatarçev 121-g, Kisella Vodë, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me numrin unik amë të subjektit (NUAS) 6122710, aktiviteti i regjistruar i te cilit është 82.91-Veprimtaria e agjencive te mbledhjes dhe pagesës së llogarive dhe zyrave të kreditit.

Ivikom Zhagubica është aktive në kërkimin e potencialit të erës dhe zhvillimin e projekteve për fermat me erë.

Për qëllimet e Njoftimit, tregu relevant i prodhimeve mund të përkufizohet si një treg për prodhimin e energjisë elektrike ose një treg për prodhimin e energjisë elektrike dhe shitjen me shumicë të energjisë elektrike nga prodhimi i vet, ndërsa shtrirja gjeografike e tregut është kombëtar, por përkufizimi i tregut relevant mund të lihet i hapur pasi përqendrimi në fjalë nuk shkakton ndonjë shqetësim në konkurrencë sipas çdo përkufizimi të mundshëm të tregut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

09.02.2022

Shkup

